EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5713
E enjte, 28 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Kosova e gatshme për marrëveshje ligjërisht obliguese me Serbinë

FAQE 3

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI FAQE 4-5

TAKSA ËSHTË I VETMI INSTRUMENT QË BLLOKON IDENË E NDRYSHIMIT TË KUFIJVE

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka mbështetur Qeverinë e Kosovës për ta mbajtur në fuqi taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se taksa është instrumenti i vetëm me të cilin po bllokohet dialogu me Serbinë dhe po mbrohen kufijtë e Republikës së Kosovës. Ajo ka deklaruar se taksa nuk duhet të hiqet derisa Kuvendi i Kosovës të votojë një platformë e cila ia vendos vijat e kuqe procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Duke folur rreth idesë së krijimit të një qeverie gjithëpërfshirës në vend për shkak të proceseve nëpër të cilat po kalon vendi, Edita Tahiri ka thënë se në këtë situatë skenari më i mirë do të ishte qeveria gjithëpërfshirëse

NJË I VDEKUR NGA GRIPI NË KOSOVË

FAQE 3

Komiteti për Gripin Sezonal në nivel të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka bërë me dije se gripi sezonal ka kaluar në epidemi në Kosovë. Sipas këtij Komiteti, është konstatuar një rast i vdekur me influencë A, ku thuhet se pacienti ka pasur sëmundje kronike përcjellëse. Instituti Kombëtar dhe ShSKUK-ja u kanë bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes të mos dalin në ambient të ftohtë, të mos

qëndrojnë në lokale të mbyllura dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina

MCC-ja: Kosova ta shtojë luftën kundër korrupsionit

FAQE 5

AKTUALE

NGUJIMI I REPUBLIKËS NË ZGAFELLE NË 30-VJETORIN E GREVËS SË MINATORËVE 1989

F. 10

Ragip SHALA

SHQIPTARËT NË BALLKAN KANË NEVOJË PËR NJERËZIT E VET NË AMERIKË

F. 7

TESTIMI I KANDIDATËVE PËR REKRUTË TË FSK-SË FILLON MË 4 MARS

F. 6

EKONOMI

DEFICITI TREGTAR SHËNOI ULJE PËR 2.1 PËR QIND

F. 8

KRU 'PRISHTINA' SHKYÇ BORXHLINJTË NGA UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI

F. 9

KULTURË

SADIJA ISHTE ENGJËLLI MBROJTËS I DRITËROIT

F. 12

Agim VINCA

TËRË JETËN NË SHËRBIM TË SHKOLLËS

F. 12

SPORT

ZHDRELLA: E MPOSHTIM PRISHTINËN

F. 15

RRETHI PARAELIMINATOR I LIGËS SË KAMPIONËVE NË 'FADIL VOKRRI" DHE "ADEM JASHARI'

F. 15

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta në Egjipt, takohet me homologun El-Sisi

TIRANË, 27 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, nisi të mërkurën vizitën zyrtare në Egjipt duke u pritur me nderimet e veçanta shtetërore nga presidenti i Republikës Arabe të Egjiptit, Abdel Fattah El-Sisi. Pas ceremonisë zyrtare të mirëseardhjes dhe interpretimit të himneve kombëtare, të dy presidentët zhvilluan një takim kokë me kokë, më pas vijuan me takimin e zgjeruar të dy delegacioneve.

Presidenti Meta vlerësoi lidhjet e forta historike dhe kulturore dhe marrëdhëniet tradicionalisht shumë të mira historike, politike, kulturore dhe njerëzore midis dy vendeve e popujve tanë. "Shqipëria mund të jetë një portë hyrëse në rajonin e Ballkanit për sipërmarrjet egjiptiane", nënvizoi kreu i shtetit.

Duke iu referuar sfidave dhe interesave të përbashkëta në rajonin e Mesdheut, presidenti Meta shprehu vullnetin për ta shfrytëzuar këtë vizitë për hapjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet midis vendeve tona.

Të dy presidentët ndanë mendimin se mundësitë e bashkëpunimit ekonomik janë shumë më të mëdha se rezultatet aktuale dhe kuadri ligjor në fuqi është stimulues në këtë drejtim.

Kreu i shtetit shqiptar dhe presidenti El-Sisi shprehën mbështetjen e tyre për një shfrytëzim më të mirë të këtyre mundësive dhe mbledhjen sa më parë të Komisionit të Përbashkët Ndërshtetëror që do t'i identifikojë të gjitha fushat e mundshme të bashkëpunimit. Një vëmendje të veçantë të dy bashkëbiseduesit ua kushtuan edhe zhvillimeve në rajonet respektive.

Presidenti Meta dhe presidenti El-Sisi ndanë mendimin se bashkëpunimi dhe solidariteti në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është i domosdoshëm për një rajon mesdhetar që zhvillohet në paqe dhe begati.

Kosova e gatshme për marrëveshje ligjërisht obliguese me Serbinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë takuar të mërkurën përfaqësuesit e lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë së ShBA-së, John Erath dhe Brad Berkley. Kryeministri Haradinaj në këtë takim ka thënë se Kosova është e gatshme për marrëveshje ligjërisht obliguese që rezulton me njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe Kosovën e 17 shkurtit 2008

PRISHTINË, 27 SHKURT - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë takuar të mërkurën përfaqësuesit e lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett. Për rrjedhën e këtij takimi ka njoftuar përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" kryeministri Ramush Haradinaj. "Në takim me përfaqësuesit e lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, John Erath dhe Brad Berkley, së bashku me presidentin e vendit tonë, theksova se Republika e Kosovës është e angazhuar në mënyrë të pakthyeshme për ta forcuar demokracinë dhe institucionet e saj", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se Kosova është e gatshme për marrëveshje ligjërisht obliguese që rezulton me njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe Kosovën e 17 shkurtit 2008. "Po ashtu, Kosova është e gatshme për marrjen e të drejtave dhe detyrimeve të anëtarësimit në NATO, Kombet e Bashkuara, BE dhe organizatat e tjera ndërkombëtare dhe për marrëdhënie të mira fqinjësore", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri ka pohuar se Kosova është e vendosur për tregti të lirë brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe, sipas tij, marrëveshja gjithëpërfshirëse ligjërisht obliguese do të përfshijë edhe rregullimin e kapitullit të tregtisë së lirë në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Gjithashtu, Kosova mbështetet në vlerat e një shoqërie shumetnike, të bazuar në të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët dhe komunitetet e saj. I mbetemi besnik miqësisë së përhershme dhe bashkërendimit të politikave me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë Haradinaj.

Cakaj: Marrëveshja Kosovë - Serbi duhet të përfundojë me njohje reciproke

SHKUP, 27 SHKURT - Zëvendësministri dhe ushtruesi i detyrës së ministrit të Jashtëm të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka deklaruar se marrëveshja finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të sjellë si rezultat njohje reciproke ndërmjet dy shteteve. Këto komente Cakaj i bëri në Shkup, ku zhvilloi një vizitë zyrtare me autoritetet e Maqedonisë së Veriut.

Dimitrov ka falënderuar homologun shqiptar Gent Cakaj për mbështetjen që Shqipëria i ka dhënë Maqedonisë së Veriut gjatë gjithë rrugëtimit në procesin e deritanishëm drejt integrimeve euroatlantike, madje duke u bërë vendi i tretë që ratifikon marrëveshje për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO.

Cakaj në Shkup ka theksuar se rrugëtimi i përbashkët i dy vendeve fqinje drejt integrimeve euroatlantike paraqet një shtytje për zhvillimin e rajonit.

Ndërkaq të pyetur se si e shohin idenë për korrigjimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë, shefat e diplomacive së të dy vendeve thanë se kjo çështje i përket Prishtinës dhe Beogradit zyrtar. "Konsiderojmë se çfarëdo lloj marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të "përfundojë me njohjen e ndërsjellë, që siguron perspektivë evropiane dhe ulëse në OKB për Kosovën, ndërkohë që përmbajtja e marrëveshjes dhe diskutimet e tjera natyrisht se këto do të duhet të konsumohen në hapësirat institucionale në Kosovë dhe mua nuk më takon të jap një përgjigje më substanciale për këtë çështje", ka thënë ushtruesi i detyrës së ministrit të Jashtëm në Shqipëri, Gent Cakaj.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Një i vdekur nga gripi në Kosovë

Komiteti për Gripin Sezonal në nivel të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka bërë me dije se gripi sezonal ka kaluar në epidemi në Kosovë. Sipas këtij Komiteti, është konstatuar një rast i vdekur me influencë A, ku thuhet se pacienti ka pasur sëmundje kronike përcjellëse. Instituti Kombëtar dhe ShSKUK-ja u kanë bërë thirrje qytetarëve të kenë kujdes të mos dalin në ambient të ftohtë, të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHKURT - Komiteti për Gripin Sezonal në nivel të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e rregullt në të cilën është analizuar situata e fundit me gripin sezonal. Në këtë mbledhje u konstatua një rast i vdekur me influencë A, ku thuhet se pacienti ka pasur sëmundje kronike përcjellëse. "Në laboratorët e Qendrës Kombëtare të gripit në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike deri më 22 shkurt janë testuar gjithsej 661 mostra të dyshimta me influencë, prej tyre 240 raste rezultojnë pozitive në influencën e tipit A", është thënë në komunikatën e ShSKUK-së, duke theksuar se kemi të bëjmë me epidemi të gripit sezonal.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar kanë rekomanduar që të gjithë nxënësit që kanë shenja të gripit të qëndrojnë në shtëpi. "Rekomandojmë që të gjitha institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme (publike dhe private), ku fëmijët dhe nxënësit kanë shenja dhe simptoma të gripit (temperaturë të lartë, lodhje, rrjedhje hundëve, dhimbje fyti, kollë, barkqitje dhe vjellje, dhimbje koke, barku dhe muskujsh) t'i shmangen kontaktit me nxënës të shëndoshë dhe të qëndrojnë në shtëpi, duke iu përmbajtur rekomandimeve të mjekut", është theksuar në këtë njoftim.

Instituti Kombëtar dhe ShSKUK-ja kanë përsëritur rekomandimet për qytetarët që të kenë kujdes të mos dalin në ambient të ftohtë, të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura me dendësi të madhe të njerëzve dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina.

MAShT-i kërkon nga drejtorët e drejtorive komunale të arsimit ta mbikëqyrin situatën rreth gripit në shkolla

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) ka kërkuar nga drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) që të mbikëqyrin situatën në komunat e tyre rreth epidemisë së gripit sezonal përmes përgjegjësve të institucioneve parashkollore, fillore dhe të mesme (publike dhe private). Këtë kërkesë MAShT-i e ka bërë duke u bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për situatën aktuale epidemiologjike të gripit sezonal.

Në kërkesën që iu është drejtuar DKA-ve, MAShT-i ka kërkuar nga përgjegjësit e të gjitha institucioneve arsimore që fëmijët dhe nxënësit që kanë shenja dhe simptoma të gripit t'i shmangen kontaktit me nxënës të shëndoshë dhe të qëndrojnë në shtëpi, duke iu përmbajtur rekomandimeve të mjekut.

OSBE-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në promovimin e lirisë së shprehjes

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën ka pritur përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Mediave, Harlem Desir, si dhe shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu.

Presidenti Thaçi i ka falënderuar përfaqësuesit e OSBE-së për investimet në dy dekadat e fundit për promovimin e lirisë së shprehjes dhe zhvillimin e mediave në Kosovë. "OSBE-ja ka investuar në shumë programe për zhvillimin e demokracisë në Kosovë përmes trajnimeve të gazetarëve dhe promovimin e lirisë së shprehjes", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e mediave, Harlem Desir, ka theksuar se kjo organizatë do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën për promovimin e lirisë së shprehjes. Presidenti Thaçi ka shtuar se OSBE-ja e ka mbështetur Kosovën në të gjitha fushat dhe institucionet shtetërore janë shumë mirënjohëse.

Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

Taksa është i vetmi instrument që b

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka mbështetur Qeverinë e Kosovës për të mbajtur në fuqi taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se taksa është instrumenti i vetëm me të cilin po bllokohet dialogu me Serbinë dhe po mbrohen kufijtë e Republikës së Kosovës. Ajo ka deklaruar se taksa nuk duhet të hiqet derisa Kuvendi i Kosovës të votojë një platformë e cila ia vendos vijat e kuqe procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Duke folur rreth idesë së krijimit të një qeverie gjithëpërfshirës në vend për shkak të proceseve nëpër të cilat po kalon vendi, Edita Tahiri ka thënë se në këtë situatë skenari më i mirë do të ishte qeveria gjithëpërfshirëse

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 27 shkurt - Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, e ka ftuar Qeverinë e Kosovës të mos heqë dorë nga taksa për produktet serbe. Ajo ka thënë se taksa është i vetmi instrument që po e bllokon idenë e ndryshimit të kufijve.Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka deklaruar se bashkësia ndërkombëtare duhet ta drejtojë presionin edhe nga Serbia. "Qeveria e Kosovës dhe vetë kryeministri Haradinaj duhet ta mbajnë taksën ndaj produkteve serbe sepse taksa tani për tani është i vetmi instrument që bllokon idetë për ndryshimin e kufijve. Për faktin se Kuvendi i Kosovës ende nuk ka arritur ta miratojë platformën me vijë të kuqe për t'i mbrojtur kufijtë e Kosovës, sovranitetin dhe pavarësinë. Taksa është i vetmi mekanizëm që bllokon dialogun", ka thënë Tahiri.

Ajo nuk beson se mosrespektimi i kërkesës amerikane për pezullimin e taksës mund të ndikojë në raportet strategjike Kosovë - ShBA. "Marrëdhëniet strategjike dhe miqësore me Amerikën nuk janë të thjeshtësuara në një dimension siç është taksa. Marrëdhënie strategjike Kosovë-ShBA janë ndërtuar tash e 30 vjet, që nga viti 1990. Ato bazën e kanë në vlera të qëndrueshme, siç është mbrojtja dhe përkrahja amerikane për pavarësinë e Kosovës dhe kufijtë e Kosovës", është shprehur ajo. Tahiri ka treguar se taksa do të duhej të hiqej vetëm pasi Kuvendi i Kosovës ta miratojë një platformë për bisedime e cila do t'i vendoste vija të kuqe dialogut në mes të dy vendeve. Sipas saj, zgjidhja më e mirë për ta dalë nga kjo situatë është formimi i një qeverie gjithëpërfshirëse. "Skenari më i mirë, sipas mendimit dhe përvojës sime në proceset e negociatave që i kemi pasur me Serbinë në Rambuje dhe Vjenë, është ky: të kemi një qeveri gjithëpërfshirëse në të cilën përfshihen LDK-ja dhe LV-ja, të ketë platformë të qartë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me vija të kuqe në mbrojtje të kufijve dhe Kushtetutës së Kosovës, si dhe delegacioni shtetëror të jetë gjithëpërfshirës sikurse edhe Qeveria", është shprehur Tahiri.

"Epoka e re": *Znj. Tahiri, Qeverisë së Kosovës po vazhdon t'i shtohet presioni për heqjen e taksës. Si duhet të veprojë ekzekutivi i vendit?*

Tahiri: Qeveria e Kosovës dhe kryeministri Haradinaj duhet ta mbajnë taksën ndaj produkteve serbe sepse taksa tani për tani është i vetmi instrument që bllokon idetë për ndryshimin e kufijve pasi që Kuvendi i Kosovës ende nuk ka arritur të miratojë platformën me vija të kuqe për t'i mbrojtur kufijtë e Kosovës, sovranitetin dhe pavarësinë. Taksa është i vetmi mekanizëm që bllokon dialogun. Pra, bllokon idenë e rrezikshme për çështjen e prekjes së kufijve të Kosovës.

Së dyti, faktori ndërkombëtar, SHBA-ja dhe BE-ja, duhet të bëjnë presion edhe në Serbi. Nuk mjafton vetëm presioni ndaj Kosovës. Në fund të fundit, kjo taksë ka qenë vetëm reagim ndaj destruksioneve të Serbisë ndaj Kosovës. Kur do ta shohim edhe reagimin dhe presionin ndaj Serbisë për të plotësuar marrëveshjen e Brukselit që i ka shkelur ose nuk i ka zbatuar, siç është marrëveshja për energjinë etj., atëherë sigurisht se edhe institucionet e Kosovës do ta marrin në konsideratë këtë presion. Është jo e drejt që të bëhet presion vetëm ndaj Kosovës.

Ilokon idenë e ndryshimit të kufijve

"Epoka e re": *Siç e kemi parë, kërkesat amerikane për këtë çështje kanë qenë permanente, prej presidentit amerikan, Departamentit të Shtetit, deri tek ambasadori në Prishtinë, të cilët kërkojnë pezullimin e taksës. A është Kosova në pozicion që të mos dëgjojë këshillën amerikane?*

Tahiri: Marrëdhëniet strategjike dhe miqësore me Amerikën nuk janë të thjeshtësuara në një dimension siç është taksa. Marrëdhëniet strategjike Kosovë - ShBA janë ndërtuar tash e 30 vjet, që nga viti 1990. Ato bazën e kanë në vlera të qëndrueshme, siç është mbrojtja dhe përkrahja amerikane për pavarësinë e Kosovës dhe kufijtë e Kosovës, si dhe përkrahja amerikane që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të dalë me verdikt të drejtë dhe të legjitimohet pavarësia e Kosovës. Këto janë gjërat parimore që e mbajnë dhe e udhëheqin aleancën strategjike Kosovë - ShBA. Prandaj, pavarësisht prej sugjerimeve amerikane për taksën, duhet t'u jepet përgjigje e drejt se, derisa vazhdojnë idetë e rrezikshme që kërcënojnë kufijtë e Kosovës, shteti ynë nuk mund të hyjë në dialog. Pastaj Kosova ende nuk ka një ekip negociator për bisedime të cilit ia ka dhënë mandatin parlamenti. Është bërë një gjysmë delegacion i cili nuk është i plotë. Kosova duhet të përgatitet mirë për këtë dialog sepse po flasim për fazën finale. Prandaj për këtë çështje duhet të ketë unitet dhe legjitimitet.

"Epoka e re": *Kur mendoni se duhet të hiqet apo pezullohet taksa sepse qëndrimi i Qeverisë është se taksa nuk hiqet deri në njohje nga Serbia?*

Tahiri: Për taksën kam një mendim timin personal. Sapo Kuvendi i Kosovës miraton platformën për bisedime me Serbinë me vijë të kuqe për mbrojtjen e Kushtetutës dhe kufijve të Kosovës, atëherë mendoj se mund të hiqet taksa.

"Epoka e re": *Tanimë ekipi negociator ka dërguar platformën për bisedime në Kuvend. E keni parë këtë dokument?*

Tahiri: Nuk e kam parë. Atë platformë do ta shikoj vetëm kur të shoh se është bashkuar spektri politik rreth saj. Po ashtu, rreth asaj platforme duhet të jetë një delegacion gjithëpërfshirës i Kosovës, i cili do t'i mbrojë vijat e kuqe. Delegacioni aktual është vetëm një delegacion i pjesshëm dhe i çuditshëm. Atij nuk i dihet mandati dhe brenda këtij kemi disa qëndrime. Në njërën anë është presidenti i cili shtyn përpara idenë e ndryshimit të kufijve, në anën tjetër kemi qëndrimin e delegacionit. Pastaj brenda këtij delegacioni kemi tre përfaqësues të PSD-së, që ende nuk dihet se çfarë legjitimiteti gëzon tek qytetarët ky subjekt politik. Kurse partia më e madhe e koalicionit qeverisës, PDK-ja, e ka vetëm një përfaqësues. Këtu nuk po shoh legjitimitet, sepse është shkelur demokracia. Ky delegacion nuk mund ta përfaqësojë Kosovën në një proces kaq të rëndësishëm.

"Epoka e re": *Meqenëse LDK-ja dhe LV-ja nuk kanë pranuar të jenë pjesë e këtij delegacioni dhe, po ashtu, kanë paralajmëruar se nuk do ta përkrahin platformën, cila duhet të jetë zgjidhja për të dalë nga kjo situatë?*

Tahiri: Skenari më i mirë, sipas mendimit dhe përvojës sime në proceset e negociatave që i kemi pasur me Serbinë në Rambuje dhe Vjenë, është ky: të kemi një qeveri gjithëpërfshirëse në të cilën përfshihen LDK-ja dhe LV-ja, të ketë platformë të qartë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me vija të kuqe në mbrojtje të kufijve dhe Kushtetutës së Kosovës si dhe delegacioni shtetëror të jetë gjithëpërfshirës sikurse edhe qeveria.

"Epoka e re": *Si do të dukej kjo qeveri?*

Tahiri: Kjo qeveri gjithëpërfshirëse do të duhej t'i përfshinte partitë e mëdha në Kuvend. Këtu kam parasysh partitë e koalicionit qeverisës, LDK-në dhe LV-në. Nëse nuk mund të arrihet 100 për qind uniteti, e rëndësishme është që kjo Qeveri të jetë gjithëpërfshirëse. Pa partitë e mëdha të opozitës nuk mund të krijohet një gjithëpërfshirje. Pra, ajo do të duhej të dukej si Qeveri e unitetit për aq sa është e mundshme. Nuk duhet të shkohet në bisedime kështu siç po tentohet të bëhet tani, sepse ne e dimë se qeveria aktuale nuk përfaqëson elektoratin e shumicës shqiptare. Ne e dimë se LDK-ja dhe LV-ja sot përfaqësojnë shumicën shqiptare në skenën politike të Kosovës.

"Epoka e re": *Kush do të duhej ta udhëhiqte këtë qeveri?*

Tahiri: E para, mendoj se kryeministri aktual Ramush Haradinaj është duke i mbrojtur shkëlqyeshëm kufijtë e Kosovës dhe Kushtetutën e Kosovës. Mirëpo, kur partitë hyjnë të gjitha në bisedime për një qeveri gjithëpërfshirëse, nuk mund të paragjykoj se si do të vendosin ato. Një parim demokratik është se partia më e madhe në vend, që tani është LDK-ja, i takon ta udhëheqë një qeveri të tillë.

"Epoka e re": *Sa do të mund të zgjaste kjo qeveri?*

Tahiri: Zakonisht, kur në vende ndodhin zhvillime të mëdha, siç është kjo marrëveshje, ajo qeveri, do të duhej të jetë në pajtim me interesat nacionale të Kosovës. Nëse vjen një marrëveshje në Kuvend dhe miratohet, atëherë zakonisht zgjedhjet janë normale. Por, për këtë duhet të vendosin vetë partitë politike.

MCC-ja: Kosova ta shtojë luftën kundër korrupsionit

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Një delegacion nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit e Qeverisë së ShBA-së (MCC) ka vizituar Kosovën javën e kaluar për të diskutuar potencialin për përdorimin e një kompakt-programi të MCC-së për ta reduktuar varfërinë dhe për të promovuar rritjen ekonomike këtu. "Bordi i Drejtorëve i MCC-së ka përzgjedhur Kosovën si të përshtatshme për një MCC kompakt program dhjetorin e kaluar. Kosova duhet të vazhdojë të tregojë përparim kundër korrupsionit në mënyrë që të marrë këtë financim dhe ndihmë", është thënë në njoftimin e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Delegacioni, i udhëhequr nga zëvendëskryetarja e Departamentit për Çështje Kongresionale dhe Marrëdhënie me Publikun, Karen Sessions, u takua me zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës dhe me udhëheqës nga sektori privat. Ata diskutuan për qasjen e MCC-së në luftën kundër varfërisë përmes rritjes ekonomike. "Një faktor që frenon rritjen ekonomike është korrupsioni lidhur me të cilin rangimi global i Kosovës është i ulët. Kosova duhet të ripërzgjedhet nga Bordi i Drejtorëve të MCC-së çdo vit të zhvillimit kompakt dhe do të vlerësohet përmes fletënotimit të MCC-së që përmban një vlerësim të përpjekjeve për reduktimin e korrupsionit", është theksuar në këtë njoftim të Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Momentalisht MCC është duke zbatuar për Kosovën Programin e Pragut të grantit të vogël i cili përkrah investimet në efikasitetin e energjisë dhe punësimin e femrave në sektorin e energjisë si dhe shtimin e të dhënave publike për gjyqësinë, mjedisin dhe fuqinë punëtore.

Më 20 shkurt 2019 zëvendëskryetarja Sessions ka ndihmuar në nisjen e projektit "Gratë në Energji", që është pjesë e Programit të Pragut të MCC-së për Kosovën. Ky projekt mbështet mundësitë për pjesëmarrjen e femrave si të punësuara dhe si ndërmarrëse në këtë sektor, kurse i rritë mundësitë ekonomike për femrat dhe përkrah një program të bursave. Momentalisht zbatohet nga Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës dhe do të vazhdojë deri në vitin 2021.

Testimi i kandidatëve për rekrutë të FSK-së fillon më 4 mars

Prishtinë, 27 shkurt (ER) - Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës përmes një njoftimi për media ka njoftuar të gjithë kandidatët që kanë konkurruar për rekrutë/OR1 të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në konkursin e shpallur më 11. 2. 2019, e të cilët i përmbushin kriteret e përgjithshme të konkurrimit, se procesi i testimit do të fillojë nga data 4 mars 2019. Testimi i kandidatëve do të bëhet sipas orarit të testimit, i cili do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht në adresën: www.mksf-ks.org nga data 1 mars 2019. Ministria e Mbrojtjes u ka uruar suksese të gjithë kandidatëve që do të marrin pjesë në procesin e testimit.

Koordinatori Hoti premton përkrahje për shkollat në Medvegjë

Medvegjë, 27 shkurt (ER) - Në vazhdën e vizitave në Luginën e Preshevës, koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, ka vizituar edhe Medvegjën, ku ka pasur disa takime. Ai është pritur nga nënkryetari i komunës, Florim Sahiti dhe ndihmësja e kryetarit, Leme Xhema. Për të parë nga afër gjendjen e arsimit të fëmijëve shqiptarë të Medvegjës, Hoti, i shoqëruar nga Sahiti dhe Xhema, vizitoi shkollën "Zenel Hajdini" në Tupallë të Medvegjës, ku është mirëpritur nga drejtoresha Arlinda Kadriu, stafi dhe nga nxënësit e kësaj shkolle.

Hoti ka shpalosur Programin Nacional për Rininë dhe ka bërë me dije se ky program do t'i barazojë nxënësit e shkollave të Medvegjës me bashkëmoshatarët e tyre në të gjitha shkollat e Kosovës dhe më gjerë. "Nxënësit e kësaj shkolle, ndonëse pak në numër, do ta kenë mundësinë të garojnë në mënyrë të barabartë me të gjithë nxënësit e komunave të tjera si dhe t'u mundësohet gara në secilën kategori të dijes, kreativitetit kulturor, mendimit kritik si dhe sportit", ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se do t'i shqyrtojë të gjitha mundësitë për t'i ndihmuar shkollës dhe nxënësve të Medvegjës.

Ndërsa Sahiti dhe Xhema e kanë mirëpritur vizitën e koordinatorit Hoti në Medvegjë dhe i kanë treguar atij problemet me të cilat po përballen shqiptarët e Medvegjës. Ata e falënderuan Hotin që e ka sjellë edhe në Medvegjë Programin Nacional për Rininë. Ndërkaq drejtoresha Kadriu përmendi problemet me të cilat përballet shkolla e saj si shkollë e vetme me nxënës dhe staf shqiptarë në Medvegjë. Pavarësisht prej këtyre, ajo tha se do të përkushtohet për realizimin e programi edhe në shkollën "Zenel Hajdini".

Gjatë qëndrimit në Medvegjë, koordinatori ka takuar edhe këshilltarët shqiptarë të opozitës në këtë komunë, Bajram Mustafën, Femi Bejiqin, Gani Krasniqin dhe Ruhan Muharremin. Në të gjitha takimet u theksua çështja e pasivizimit të adresave të shqiptarëve në vendlindjen e tyre, me theks të veçantë në Medvegjë, që po përbën shqetësim të jashtëzakonshëm dhe po rrezikon substancën kombëtare shqiptare në Medvegjë.

Jakup Krasniqi: Nisma po zhvillohet dhe fuqizohet

Prishtinë, 27 shkurt (ER) - Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka folur për posëvjetorin e themelimit të këtij subjekti politik. Krasniqi në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se para pesë vjetëve, kur vendosën për ta themeluar Nismën për Kosovën, ishin të bindur se Kosovës dhe qytetarëve të saj i duhej një parti qytetare e orientimit të majtë. "Një parti që sjellë një frymë të re solidariteti për njeriun tonë. Pas pesë vjetëve vazhdojmë të jemi të bindur se Kosovës, qytetarëve tanë, u duhet një parti e fuqishme socialdemokrate", ka shkruar Krasniqi.

Krasniqi ka theksuar se socialdemokratët e Nismës po e sjellin një frymë të re komunikimi dhe bashkëpunimi në vend. "Kjo frymë njerëzore e komunikimit edhe me kundërshtarët politikë ka bërë që Nisma të zhvillohet e të fuqizohet nga viti në vit", ka shkruar Krasniqi. Ai ka shtuar se politikat që po i zbaton Nisma Socialdemokrate në qeverinë aktuale, në ministritë që udhëheq, janë politika sociale dhe solidare. "Janë politika që nxisin dhe mbrojnë prodhimin vendor dhe arsimin cilësor, dijet shkencore dhe profesionale", ka deklaruar Krasniqi.

Hoti kërkon përkrahjen e Italisë për Kosovën në proceset integruese

Prishtinë, 27 shkurt (ER) - Kryetari i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Cristoforo Sardin. Hoti e ka falënderuar ambasadorin Sardi për bashkëpunimin që ka ofruar shteti italian deri më tani për Kosovë. Gjatë këtij takimi Hoti e ka njoftuar ambasadorin lidhur me situatën aktuale politike në vend, në veçanti lidhur me temën e dialogut Kosovë - Serbi, për të cilën temë Hoti ka ritheksuar edhe një herë qëndrimin e LDK-së. Gjithashtu, në këtë takim u bisedua edhe për proceset e tjera eurointegruese në për të cilat po kalon vendi dhe me këtë rast Hoti ka kërkuar mbështetjen e mëtejme të Italisë sa iu përket këtyre proceseve. Ndërsa ambasadori Sradi ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të shtetit italian për thellimin e këtij bashkëpunimi për të qenë çdo herë afër institucioneve të vendit në rrugëtimin drejt integrimit evropian.

Shqiptarët në Ballkan kanë nevojë për njerëzit e vet në Amerikë

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë pritur në takime të veçanta anëtarin e Këshillit Bashkiak të Nju Jorkut, Mark Gjonaj dhe delegacionin shqiptaro-amerikan. Presidenti Thaçi ka vlerësuar lart kontributin e komunitetit shqiptar në ShBA dhe ka shprehur falënderim për ndihmën që ka dhënë dhe vazhdon të japë për Kosovën.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe asamblisti Mark Gjonaj kanë diskutuar për zhvillimet politike, për arritjet e Kosovës në shumë fusha dhe për sfidat që ajo ka para vetes. Veseli e konsideroi të një rëndësie të veçantë integrimin dhe depërtimin e shqiptarëve në jetën politike dhe institucionale të vendeve perëndimore në të cilat jetojnë dhe veprojnë.

Kreu i Kuvendit ka theksuar se rasti i Mark Gjonajt është shembulli më i mirë i këtij integrimi, falë edhe mundësive që shteti amerikan ua jep të gjithë shtetasve të tij. Veseli ka shtuar se shqiptarët në Amerikë vazhdojnë të shërbejnë si një urë e fuqishme lidhjeje midis SHBA-së dhe vendeve prej nga vijnë. Ai ka thënë se diaspora vazhdon të mbetet një prej aseteve kryesore të shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj, ndërsa ka theksuar nevojën për gjetjen e mënyrave për investim më të madh në Kosovë të ndërmarrësve shqiptarë në diasporë.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka nderuar Mark Gjonajn me dekoratën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, me motivin e lartësimit të vlerave shqiptare kudo që janë, veçanërisht në Amerikë. Haradinaj ka theksuar se gjatë takimit janë diskutuar tema të ndryshme, nga shqetësimet e punët e Kosovës, punët e shqiptarëve kudo që jetojnë. "E kemi një situatë festimi më 3 mars, ku shqiptarët votojnë për Këshillin e Tuzit dhe ftojmë shqiptarët të votojnë dhe t'i gëzohen komunës së vet", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke ftuar edhe institucionet e Malit të Zi t'i gëzohen këtij suksesi të shqiptarëve në Tuz.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se shqiptarët në Ballkan kanë nevojë për njerëzit e vet në Amerikë, që të vazhdojnë të qëndrojnë afër temave të Kosovës në Amerikë.

Anëtari i Këshillit Bashkiak të Nju Jorkut, Mark Gjonaj, ka thënë se është një nder i veçantë prania e tyre sot në Kosovë. "Pasioni dhe emocionet që kam teksa kaloja në bulevard dhe mbërritja në Prishtinë, te ky popull dhe komb i mrekullueshëm, është diçka që do ta kujtoj edhe për shumë vjet të tjera që do të vijnë. Bujaria e kryeministrit Haradinaj dhe çiltërsia e tij janë të jashtëzakonshme", ka deklaruar Gjonaj, duke shtuar se dialogu mes tyre dhe kryeministrit Haradinaj do të vazhdojë.

Gjonaj ka thënë se në takimin e sotëm diskutuan për interesin e agjendës nacionale, të ardhmen e Kosovës, veçanërisht raportet në mes të Kosovës dhe komunitetit të shqiptarëve që jetojnë në Amerikë. "Faleminderit për mikpritjen tuaj dhe punën që po e bëni dhe punën që do ta bëjmë së bashku në të ardhmen që të mbrojmë historinë, kulturën, njerëzit tanë dhe shqiptarët kudo që jetojnë nëpër botë!", ka theksuar Gjonaj.

Kuvendi i Kosovës shpenzoi mbi tetë milionë për vitin 2018

PRISHTINË, 27 SHKURT - Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, në prezantimin e raportit vjetor për vitin 2018, të shpenzimeve në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ka thënë se janë mbi tetë milionë euro shpenzime. Mirëpo, në mungesë të kuorumit dhe për shkak të mosvotimit të opozitës, ky komision nuk e ka miratuar raportin. "Shpenzimet për vitin 2018 janë mbi tetë milionë euro paga, mëditje, mallra, shërbime, shpenzime komunale, subvencione, transferime, shpenzime kapitale. Mjetet e ndara për pavarësi prej 100 mijë eurosh nuk janë shpenzuar pasi nuk ka pasur kërkesa", ka thënë Krasniqi.

Lidhur me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare të deputetëve, ai ka shtuar se i merr përsipër Kryesia e Kuvendit. "Të gjitha udhëtimet zyrtare i merr Kryesia e Kuvendit. Aty planifikohet formati i delegacionit dhe qëllimi i udhëtimit", ka shtuar ai.

Kryetari i Komisionit, Lumir Abdixhiku, e ka quajtur të paarsyeshme shpenzimin e 60 mijë eurove vetëm për tre muaj. "A keni një listë të subvencioneve që janë dhënë për Kuvendin, sepse mbi 120 mijë euro janë shumë e madhe. Unë i kam mbledh shpenzimet dhe udhëtimet e deputeteve, ata në bileta 46 mijë euro, mbi 30 mijë euro mëditje, mbi 20 mijë euro akomodim, do me thënë 90 mijë euro, ndërkaq personeli mbështetës politik i kryetarit të Kuvendit mbi 60 mijë euro. Mua më duken shumë këto shpenzime", ka thënë Abdixhiku.

Ndërsa deputetja e PDK-së, Safete Hadergjonaj, ka thënë se do të ishte në rregull që ta shihnin raportin e shpenzimeve për të gjitha institucionet. "E kuptoj edhe pozitën edhe opozitën. Është e logjikshme të shkojmë me tone kritikuese, por jo në atë mënyrë që ta lëshojmë poshtë kredibilitetin e institucionit", ka thënë Hadergjonaj.

Sipas buxhetit për vitin 2018, Kuvendit të Kosovës për paga dhe mëditje i janë ndarë 7.26 milionë euro, për mallra dhe shërbime 2.31 milionë euro, për shpenzime kapitale 1.49 milion euro, për shpenzime komunale 241 mijë euro dhe subvencione e transferime 140 mijë euro.

DEFICITI TREGTAR SHËNOI ULJE PËR 2.1 PËR QIND

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin janar 2019, të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për 2.1 për qind në muajin janar të këtij viti në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 166.9 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 170.5 milionë eurosh në vitin 2018

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Tregtisë së Jashtme lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin janar 2019. Sipas ASK-së, të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për 2.1 për qind në muajin janar 2019, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 166.9 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 170.5 milionë eurosh në vitin 2018. "Eksporti mbulon importin me 12.3 për qind. Eksporti i mallrave në muajin janar 2019 kishte vlerën 23.4 milionë euro, ndërsa importi kishte vlerën prej 190.4 milionë eurosh, ku është një rënie prej (-4.3 përqindësh) për eksport si dhe një rënie prej (-2.4 përqindësh) për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018", është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit, 36.8 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13.2 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 12.2 për qind e përbëjnë produktet minerale; 7.1 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 6.1 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 5.4 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 4.9 për qind e përbëjnë produktet bimore etj. "Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import e përbëjnë: 18.1 për qind produktet minerale; 11.8 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.4 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 8.5 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 8.5 për qind mjetet e transportit; 7.9 për qind produktet e industrisë kimike; 5.5 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre etj", thuhet në publikimin e ASK-së.

Sipas ASK-së, eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 8.9 milionë euro, ose rreth 38 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 40.8 përqindësh. "Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (9.3 për qind), Italia (8.5 për qind), Holanda (5.2 për qind), Britania e Madhe (3.9 për qind). Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 99.2 milionë euro, ose 52.1 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 55.5 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (11.7 për qind), Sllovenia (7.3 për qind), Greqia (6.2 për qind), Italia (4.8 për qind), Bullgaria (4.3 për qind) etj. Në muajin janar 2019, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 7.4 milionë euro, ose 31.9 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-22.8 përqindësh). Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (10.9 për qind), Maqedonia (8.7 për qind), Serbia (6.1 për qind), Mali i Zi (4.9 për qind)", thuhet në publikim.

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin janar 2018 arritën në 19.8 milionë euro, ose 10.4 për qind të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-46.5 përqindësh). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia (5.7 për qind), Shqipëria (3.6 për qind) dhe Serbia (0.4 për qind). "Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 7 milionë euro, ose 30.1 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: India (14.9 për qind), Zvicra (9.0 për qind). Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 71.3 milionë euro, ose 37.5 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (10.9 për qind) dhe Turqia (10.4 për qind)", është thënë në publikimin e ASK-së.

Ambasadori francez i jep mbështetje ministres së re të Bujqësisë

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka takuar të mërkurën ministren e re të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq. Chabert, duke e uruar ministren Ziviq për detyrën e re, konfirmoi angazhimin e shtetit francez për të ofruar ndihmë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit. Ndërkaq ministrja Ziviq e ka njoftuar ambasadorin francez me planin e punës për zhvillimin e bujqësisë, me programet mbështetëse të ministrisë për sektorin e bujqësisë, si dhe me projektet që do të zbatohen për t'i mbështetur prodhuesit bujqësorë gjatë këtij viti.

ODA AMERIKANE NJOFTON INVESTITORËT POTENCIALË ME MUNDËSITË E INVESTIMIT NË KOSOVË

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Oda Ekonomike Amerikane (OEAK) ishte nikoqire e përfaqësuesve të fondit "River Styxx Capital", me seli në Sofje të Bullgarisë, që drejtohet nga Elvin Guri, i cili është edhe investitor i mirënjohur nga Shqipëria që operon në Bullgari. Gjatë takimit u diskutua për interesimin e kompanisë "River Styxx Capital" për investime në Kosovë në sektorë të ndryshëm që ofrojnë mundësi për investime.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka mirëpritur interesimin e Gurit dhe të kompanisë së tij për shtrirje të investimeve edhe në Kosovë, derisa e ka konsideruar shumë pozitive për tërë rajonin edhe përfshirjen e kësaj kompanie në telekomin shqiptar. Kompania "River Styxx Capital" së fundmi ka shtrirë praninë edhe në sektorin e telekomit në Shqipëri pas marrëveshjes së arritur për blerjen e Telekom Albania.

AKP-ja SHPALLI REZULTATET E SHITJEVE PËRMES LIKUIDIMIT NR. 44

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën ka mbajtur ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 44 përmes metodës së likuidimit, ku shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 93 asete sa ishin në shitje konkurruan 157 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 7 535 397 euro. "Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente para përfaqësuesve të medieve, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm", është thënë në njoftimin për medie.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve investitorëve privatë-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

KRU 'Prishtina' shkyç borxhlinjtë nga ujësjellësi dhe kanalizimi

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" ka njoftuar të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Drenas dhe Graçanicë, se aksioni për shkyçjen individuale të konsumatorëve borxhlinj nga shërbimet e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për shkak të mospagesave ndaj shërbimeve të ujit dhe kanalizimit është duke vazhduar me ritëm të lartë si në qendra të qyteteve, po ashtu edhe në fshatra. "Ky aksion ka filluar më 1 shkurt 2019 dhe do të vazhdojë deri në dhjetor 2019. Ne kemi shtuar aktivitetet për arkëtimin e borxheve edhe përmes detyrimit/shkyçjes së shërbimit, padive gjyqësore, përmbaruesve privat etj. Natyrisht kjo shkakton shpenzime shtesë për buxhetin familjar", ka njoftuar KRU "Prishtina".

Sipas kësaj kompanie, vërejtja me shkrim kushton 3.24 euro, shkyçja e rikyçja e ujit 20.00 euro dhe shpenzimet e përmbaruesit privat 18 për vlerën totale të borxhit të akumuluar. KRU "Prishtina" ua ka bërë me dije konsumatorëve të vet se pagesa e faturave të ujit dhe kanalizimit është detyrim ligjor.

Mbyllen pesë lokale të masazhit në kryeqytet

Prishtinë, 27 shkurt (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se gjatë një aksioni të ekipeve të inspeksionit janë mbyllur pesë lokale të masazhit në kryeqytet për shkak të mungesës së pëlqimit sanitar. "Gjatë një aksioni të ekipeve të inspeksionit u mbyllën 5 lokale të masazhit në kryeqytet për shkak të mungesës së pëlqimit sanitar. Gjoba nga 1 000 euro për të gjitha ato, gjoba të tjera për pirje të duhanit në hapësira të mbyllura, si dhe gjoba për mungesë të librezave sanitare në disa të tjera. Vërejtje: Drejtoria e Inspeksionit ka kompetencë vetëm për kontroll sanitar në këto lokale, e jo edhe për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

Asamblistja e LB-së në Prishtinë i bashkohet AAK-së

Prishtinë, 27 shkurt (ER) - Asamblistja e Lëvizjes për Bashkim (LB) në Kuvendin Komunal të Prishtinës, Bukurije Canolli-Ahmeti, i është bashkuar Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Lajmin e ka bërë me dije lideri i AAK-së dhe kryeministri Ramush Haradinaj. "Nga sot asamblistja e Kuvendit Komunal në Prishtinë, Bukurije Canolli-Ahmeti, do t'i bashkohet rrugëtimit të grupit të asamblistëve të AAK-së në kryeqytet, që së bashku ta fuqizojnë zërin e qytetarëve dhe të kontribuojnë për një qeverisje më të mirë komunale", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Bahtiri ofron mbështetje për zhvillimin e projekteve të DTC-së

Mitrovicë, 27 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në një takim udhëheqësen e Zyrës Gjermane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Anja Becky, dhe drejtorin e Diakonie Training Center në Mitrovicë, Bernd Baumgarten, me të cilët ka biseduar për hapat e mëtutjeshëm të bashkëpunimit. Me këtë rast, udhëheqësja Anja Becky ka falënderuar kryetarin Bahtiri për mundësinë e realizimit të kësaj vizite, duke thënë se është shumë krenare me të për bashkëpunimin e mirë që kanë ndër vite në fushën e zhvillimit ekonomik. "Një projekt me të cilin krenohemi është edhe Diakonie Training Center, të cilin e vlerësojmë lart për programet që sjell kjo qendër trajnuese për rininë dhe ofrimin e zanateve të ndryshme. Me të vërtetë është bërë një punë e madhe dhe ka pasur investime të mëdha. Prandaj kërkojmë edhe mbështetje nga komuna juaj për vazhdimin e projekteve dhe të jenë të realizueshme", ka thënë Becky.

Edhe drejtori i Diakonie Training Center (DTC), Bernd Baumgarten, ka falënderuar kryetarin Bahtiri për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e mirëfilltë që kanë pasur ndër vite. Ndërsa kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka ofruar mbështetje për zhvillimin e projekteve të DTC-së.

Aktakuzë ndaj personave që u kapën me 1 100 kilogramë mish të prishur

Pejë, 27 shkurt (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës ka ngritur aktakuzë kundër katër personave në qytetin e Pejës për shkak të dyshimit për kryerjen e veprës penale "Prodhim dhe vënie në qarkullim të artikujve të dëmshëm ushqimorë".

Të dyshuarit, S. Sh, R. Sh, M. B. dhe J. B., sipas Prokurorisë Themelore në Pejë, më 16 janar të këtij viti, në bashkëveprim, kanë vënë në qarkullim artikuj të dëmshëm ushqimorë për shëndetin e njerëzve. Këtë veprim ata dyshohet se e kanë bërë pavarësisht se ishin në njohuri se produkti ishte i dëmshëm për konsumin njerëzor. Identifikimi i mishit të prishur u bë nga inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë muajin e kaluar.

Mishi i prishur planifikohej që të shitej për konsum publik mirëpo, pas konstatimit se mund të shkaktojë dëme për shëndetin e njeriut, e gjithë sasia është asgjësuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. "Inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, pas konstatimit të gjendjes faktike të mishtit të sëmurë, urdhërojnë konfiskimin dhe asgjësimin e tij, në sasi prej 1 089 kilogramë mish, i cili ishte i destinuar për konsumim publik. Prokurori i çështjes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprën penale e cila iu vihet në barrë", është thënë në njoftimin për media.

NGUJIMI I REPUBLIKËS NË ZGAFELLE NË 30-VJETORIN E GREVËS SË MINATORËVE 1989

Ragip SHALA

Pas pranverës republikane të '81-s, Kosova u ngujua nga masat e gjendjes së jashtëzakonshme, diferencimet ideo-politike, represioni i regjimit komunist të RSFJ-së që rezultoi me burgosje të 5 000 "nacionalistëve" dhe ndalimin e torturimin e më se 500 000 shqiptarëve në "stranica" të milicisë për veprimtari "nacionaliste" dhe "irredentiste".

Komunistët e Kalimegdanit: Ali Shukriu, Azem Vllasi, Kolë Shiroka, Sinan Hasani, Rrahman Morina etj., nuk u mjaftuan me vetëm kaq tirani ndaj Kosovës. Ata pasi "qëruan hesapet" me komunistët gjakovarë: Mahmut Bakallin, Fadil Hoxhën, Xhavit Nimanin, Ali Hadrin, suprimuan rezolutën e Konferencës së Bujanit, ndryshuan pamjen e flamurit kombëtar shqiptar, shkuan edhe më tej, shpallën "martir" Gjorgje Martinoviqin.

Në shenjë besnikërie ndaj patronëve të tyre beogradas i hapën rrugë edhe degradimit të pozitës juridiko-politike të KSA Kosovës.

Në shtator 1988 Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste dhe Kryesia e KSA Kosovës propozuan ndryshimin e pozitës kushtetuese të KSA Kosovës, me arsyetim se "Kosova nuk humb asgjë" nga ndryshimet kushtetuese.

Ky kapitullim i marionetave të Beogradit përballë aspiratave hegjemoniste serbe shkaktoi revolta në gjithë Kosovën. Të parët ngritën zërin minatorët e "Trepçës" duke marshuar në Prishtinë, pastaj atyre iu bashkëngjit i tërë populli, që rezultoi me tubime dhe demonstrata njëjavore në nëntor 1988 kundër nacional shovinizmit serb dhe marionetave, komunistëve të Kalimegdanit.

Në janar 1989 K. K. i Lidhjes Komuniste dhe Kryesia e KSA Kosovës, përkundër vullnetit të popullit, miratuan propozimin e komisionit për ndryshime kushtetuese. Në shkurt 1989 e tërë Kosova ishte ngujuar nga masat represive të regjimit komunist të Beogradit.

Në ato rrethana ngujimi të Kosovës, minatorët e "Trepçës", pasi kishin "shterur" të gjitha shtigjet mbi tokë, marrin vendim që të ngujohen nën tokë. Pikërisht më 20. 2. 1989, në horizontin e nëntë të minierës së Stantërgut, u ngujuan 1 300 minatorë grevistë. Greva e minatorëve ishte një kundërvënie krejt e veçantë kundër nacional-shovinizmit dhe hegjemonizmit serb. Si e tillë, ajo i "shkeu" maskën LKJ-së si "avangardë e klasës punëtore" dhe promotore e "barazisë nacionale" në RSFJ. Ngujimi i minatorëve bëri jehonë jo vetëm në RSFJ, por edhe përtej Atlantikut. Vendosmëria për sakrifica deri në flijim shkaktoi një solidarizim në tërë Kosovën.

Një solidarizim i tillë me minatorët u shfaq edhe në Qendrën Studentore, atje u barrikaduan 15 000 studentë në përkrahje të minatorëve grevistë. Ngujimi i 1 300 minatorëve në zgafelle dhe i studentëve në palestrën sportive të Qendrës Studentore shkaktoi një betejë politike në mes të LKJ-së dhe lëvizjes klandestine - LPK-së. Lidhja Komuniste e Kosovës ishte për Kosovën krahinë, kurse Lëvizja klandestine - LPK-ja - ishte për Kosovën Republikë.

Lidhja Komuniste e Kosovës u nda në dy banda komunistësh për statusin e Kosovës: njëra bandë ishte për Kosovën krahinë sipas Kushtetutës së vitit 1974, banda tjetër sipas Kushtetutës së vitit 1963. Të dy bandat komuniste në Prishtinë, të shkëputura krejtësisht nga "klasa punëtore" e Kosovës, nuk e "qanin" hallin e Kosovës karshi nacionalizmit dhe hegjemonizmit serb, por hallin e pozitave personale në pushtetin e regjimit millosheviqian.

Zgafella në horizontin e nëntë dhe Qendra e Studentëve u bënë një kunj magnetik që do të rrotulloheshin tri opsione politike që, mbase, varej fati jo vetëm i KSA, Kosovës, por edhe i RSFJ-së.

Opsioni i parë që "varej" në kunjin e grevistëve vinte nga Beogradi, opsioni i dytë nga Prishtina, kurse opsioni tretë i sfidoi të dy opsionet: Kosova krahinë dhe angazhohej për Kosovën Republikë.

Greva e minatorëve në horizontin e nëntë u bë një arenë e betejës politike në mes të LKJ-së dhe LPK-së. Kjo betejë, që për shumë vite ishte zhvilluar mbi tokë, tani po bartej në thellësinë e tokës së Kosovës.

Horizonti i nëntë, si një arenë gladiatorësh me minatorët e ngujuar, u bë një arenë politike edhe në mes të centralizmit hegjemonist serb dhe decentralizmit slloven e kroat në federatën jugosllave. Meqë erdhi një moment që fati i RSFJ-së po varej nga grevistët, prandaj atje "zbriti" Stipe Shuvari, kryekomunisti i KQ të RSFJ-së dhe Skojisti i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste, Azem Vllasi.

Në zgafelle zbritën edhe "djemtë" klandestinë: Durak Kabashi, Sinan Kryeziu dhe Ragip Shala, autor i këtij shkrimi. Stipe Shuvari në horizontin e nëntë deklaroi se: "Ovde se brani Jugosllavia" (Këtu mbrohet Jugosllavia)!

Azem Vllasi përmes intrumentalizimit të minatorëve, mbase për ta mbrojtur vetëm veten! "Djemtë" klandestinë, pavarësisht rrezikut, bartën në zgafelle te minatorët mesazhin e Lëvizjes Klandestine të LPK-së për Kosovën Republikë.

Meqë RSFJ-ja po rrezikohej nga hegjemonizmi serb, mbrojtja e saj mbase mund të gjente mbështetje vetëm në Republikën e Kosovës. Dhe kur pritej në bazë të koordinimit në mes të studentëve dhe minatorëve grevistë për të dalë me vetëm një kërkesë: Kosova Republikë, ndodhi thyerja.

Zekeria Cana do të hynte te studentët për të njoftuar se: "Meqë u janë plotësuar kërkesat e minatorëve, ata e kanë përfunduar grevën…"?! Më kot janë përpjekur "djemtë" klandestinë: Ahmet Gashi, Blerim Dervishi, Mejdi Gega, Nesim Morina, Shaqir Kryeziu, Ruzhdi Kolgeci, Ruzhdi Cikaqi, Fehmi Mujota, Sinan Kryeziu, Ragip Shala etj., që t'i bindnin studentët të qëndronin edhe më tej në sallë, por "krahinorët" e fituan betejën. Minatorët me sy mbyllur dhe me fotografinë e satrapit Tito po dilnin mbi sipërfaqe të tokës të mashtruar dhe të tradhtuar nga eunukët e LKJ-së. Në sipërfaqe nga zgafellja doli krahina e Kosovës, në zgafelle mbeti e ngujuar Republika për disa vjet. Mbas përgjakjes së RSFJ-së nga nacionalë shovinistët dhe hegjemonistët serbë, Republika e Kosovës do të dalë në sipërfaqe nga lufta çlirimtare e UÇK-së kundër okupimit serb.

Muharremaj thotë se do të vazhdojë pastrimi i lumenjve në Suharekë

SUHAREKË, 27 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se do të vazhdojë pastrimi i lumenjve në tërë territorin e kësaj komune. Ai ka thënë se janë të përkushtuar për ruajtjen e ambientit. "Përkushtimi ynë është serioz për ruajtjen e ambientit, andaj edhe ndihma nga ana e qytetarëve do të jetë e mirëpritur. Nëse secili e kemi nën kujdes ambientin e lagjeve në qytet, fshatrave dhe kudo ku jetojmë, e mira e përbashkët është se e trashëgojmë për brezat e ardhshëm, Komunën të gjithë e duam, me ambient të pastër dhe të shëndetshëm", ka deklaruar Muharremaj.

Lekaj premton realizimin e projekteve lokale infrastrukturore në Vitomiricë

PRISHTINË, 27 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, të mërkurën ka vizituar qytetarët e Vitomiricës, nga të cilët ka dëgjuar kërkesat për projektet infrastrukturore që kanë nevojë për intervenim nga MIT-ja në fshatin Vitomiricë të Pejës. Ai u premtoi banorëve të këtij fshati se rrugët që i vizituan do të ndërtohen nga MIT dhe ato do të realizohen me gjithë infrastrukturën përcjellëse, në mënyrë që komuniteteve që jetojnë në harmoni të plotë këtu t'u mundësohet jetesë më e mirë dhe eliminim i pengesave në zhvillimin e bizneseve që ata kanë.

Lekaj ka thënë se të gjithë qytetarët e Kosovës dhe kërkesat e tyre legjitime për intervenim në projekte infrastrukturore të domosdoshme do të gjejnë mbështetje nga qeveria Haradinaj, përkatësisht ministria që ai e drejton. Për realizimin e projekteve të deritashme banorët që jetojnë në këtë fshat ministrit Lekaj i dhanë falënderim për kontributin e dhënë për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të jetesës së komuniteteve që jetojnë në Vitomiricë.

SADIJA ISHTE ENGJËLLI MBROJTËS I DRITËROIT

Agim VINCA

Ditën që në gazetën "Dita" u botuan kujtimet e mia për Dritëroin, më 9 shkurt, qëllova në Tiranë. Erdhëm bashkë me time shoqe për ta vizituar vajzën, që jeton në Tiranë. U lidha me telefon me Sadijen dhe e ftova të pinim një kafe bashkë në ndonjë lokal. Më tha: "Ju pres në shtëpi!". Dhe, natyrisht që shkuam. Na pritën me shumë dashuri si gjithmonë, Sadija dhe nusja e djalit, Majlinda. Për herë të parë shkoja në atë sallon pas ikjes së Dritëroit. U ulëm rreth



Z shtunë, 9.2.2019

Flutures dhe Agimit,

Po ju dhuroj këtë libër me një përmbledhje të poezive lirike, që u botua me rastin e 86-vjetorit të tij. Ai kishte mbyllur dhe mësu e di a do të ishte i kënaqur me këtë përmbledhje që i bëmë ne, por do të gëzohej si për çdo botim të tij.

Ju, Agim dhe Flutura, mbetem mirënjohës me të mirë që na keni dashuri gjithë një. Me dashuri Sadija.

tryezës, ku kam ndenjur shumë herë, por tani, në vend të Dritëroit, kisha përballë Sadijen, ulur në vendin e tij. Ndërsa sodisja në mur portretet e të dyve punuar nga piktorja Lumturi Blloshmi (Sadija e re, e bukur si flutur, kurse Dritëroi me portretin e tij karakteristik, me tipare të malësorit të jugut), m'u kujtuan vargjet e "Turkeshës" së famshme: *"E ku ta lija një lanete,/ Një xhinde Shkodre, një kaproll, / Ajo më not do çante dete/ Dhe do më gjente në Anadoll".*

Nuk mungoi rakia as kësaj radhe. As biseda e përzemërt si gjithmonë. Më tha se i kishte lexuar kujtimet e mia për Dritëroin dhe se i kishin pëlqyer. Në to përmendet shpesh edhe emri i saj, sepse shumë herë kishin qenë bashkë në takime letrare. Më pyeti se si i kisha mbajtur mend gjithë ato detaje. "E kam një kompjuter të vogël këtu" - i thashë me shaka dhe preka tëmthin me gisht. Vuri buzën në gaz dhe më tha: "Je i ri". "Po, po, i ri - ia ktheva. Kam lindur kur Dritëroi e botoi vjershën e parë në '47-n!".

Na dhuroi botimet më të reja të Dritëroit, bërë nën kujdesin e saj dhe të së bijës, Elonës. Me një përkushtim të gjatë e të përzemërt dhe me një shkrim shumë të ngjashëm me atë të Dritëroit. U habita. A ndodh që edhe shkrimi t'u ngjajë dy njerëzve që jetojnë gjatë bashkë? Si duket po.

Sadija ishte shumë e përkushtuar ndaj Dritëroit. Ishte shoqe jete dhe bashkëpunëtore e tij. "Me këta dy gishta ia kam shtypur librat", tha.

Vjershat, poemat, romanet, sidomos "Arkën e djallit", që është libri i tij më i vëllimshëm.

Thuhet se prapa një burri të suksesshëm qëndron një grua. Por Sadije Agolli ishte edhe vetë grua e suksesshme: nënë dhe bashkëshorte shembullore, por edhe intelektuale, gazetare e letrare. Sepse dikur ka botuar me sa di edhe tregime.

Kur nata e shkurtit po e kaplonte Tiranën, u përshëndetëm me Sadije Agollin. As ndër mend nuk më shkonte se ky do të ishte takimi ynë i fundit me të. Dukej shumë mirë dhe plotësisht e kthjellët. Nuk më pëlqeu që nuk dilte fare nga shtëpia dhe i thashë, si motrës, të mos mbyllej në burg shtëpiak. Të njëjtën gjë ia thashë edhe Elonës të nesërmen, në takimin që pata me të në zyrë, ku numri i librave që mora me vete u shtua shumë. Elona është edhe botuese, kurse botimet e saj shquhen për cilësi e përkujdesje edhe grafike.Gruaja që jetoi pesë dekada me poetin bohem, kurse katër vitet e fundit të jetës i ndenji qiri në këmbë, duke u kujdesur për shëndetin e tij, sikur e humbi shijen e jetës pas ikjes së tij. Ngushëllim gjente te kujdesi për dorëshkrimet e tij dhe te kujtimet për të. Ajo, Sadije Dritëro Agolli, siç do të mund të thoshim siç e kishte zakon të thoshte posesivi Lasgush për të shoqen, Nafijen: "Nafije Lasgush Poradeci".

Eh, ç'sakrifica që bëjnë gratë e poetëve!

I shkoi pas në krye të dy viteve. Nuk na besohet se iku kështu papritur. U prehtë në paqe!

TËRË JETËN NË SHËRBIM TË SHKOLLËS

Shkolla e Mesme Teknike "Anton Çetta" në Skenderaj kishte fatin e madh që për sekretar shkolle kishte juristin Dibran Shala. Duke qenë i vetëdijshëm se dokumentacioni ka rëndësi të veçantë për historikun e një institucioni, veçmas për një shkollë të mesme me mbi 1 000 nxënës, siç ishte shkolla "Anton Çetta", Dibrani ishte i përkushtuar për mirëvajtjen dhe sistemimin e dokumentacionit, sepse ai një ditë duhej të mbetej në arkivin dhe historikun e saj.

Pos punës së përkushtuar, Dibranin e karakterizonte edhe karakteri i fortë në punë dhe jetë. Me rastin e largimit të dhunshëm të nxënësve dhe arsimtarëve nga objektet e tyre shkollore, siç kishte ndodhur edhe me objektin e shkollës "Anton Çetta" në Skenderaj, i cili më pas ishte mbushur me kolonë serbë të ikur nga Kroacia, si pasojë e luftës së atjeshme, Dibrani kujdesshëm mblodhi tërë dokumentacionin e shkollës dhe e vendosi në shtëpinë e vet në Skenderaj, për të mos rënë në dorë të fashistëve serbë, që do të mund të digjej e humbej, dokumentacion ky që, pastaj Dibrani, pas luftës, ia ktheu shkollës, me të cilin dokumentacion me vlerë të madhe për historikun e saj, por edhe cilësinë e sistemimit, ruhet e shërbehet me shumë kujdes nga shkolla.

Pas dëbimit nga shkolla, të cilën Dibrani e kishte përjetuar tepër rëndë, ai 20 vjet më parë, përjetoi edhe tragjedinë familjare, kur pushtuesi serb i vrau mizorisht djalin, Musliun dhe dhëndrin, Sabitin.

Dibran Shala u lind më 25 janar të vitit 1938 në fshatin Burojë dhe ndërroi jetë më 28 shkurt 2018. Nder e respekt punës dhe veprës së Dibran Shalës.

E jashtëzakonshme

Balena gjigante gjendet brenda në pyll

Një balenë gjigante është gjetur në një pyll në Brazil, në ishullin Marajo në Soure. Krijesa e madhe u gjet javën e kaluar, pothuajse e ngordhur në një distancë të vogël larg nga bregu i Amazon River. Balena ishte njëvjeçare dhe tetë metra e gjatë. Trupi i saj u gjet 15 metra larg nga plazhit, i futur brenda pyllit. Nuk dihet se si balena ka përfunduar brenda në pyll.

FOTO E DITES

Skiatorët me balona konkurrojnë gjatë kampionatit të parë në lumin Yenisei të mbuluar me akull në Rusi. /Fotoja është publikuar tek Zëri i Amerikës/

E rrallë

Miu i shëndoshë ngecën në puset, zjarrfikësit ndërhyjnë ta shpëtojnë

Aventurë e keqe për miun me mbipeshë. Derisa po tentonte të ikte nga një puset, miu ka ngecur në një nga vrimat e pusetës. Madje për ta shpëtuar ndërhynë edhe zjarrfikësit. "Edhe kafshët që shumë i urrejnë meritojnë të trajtohen me respekt", ka thënë Michael Sher, një nga zjarrfikësit që shpëtoi miun.

BARSOLETA E DITËS

- Me çfarë veprimi mund ta zhbllokojë polici kaosin në udhëkryq?
- Vetëm nëse merr pauzë.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI Nëse nuk doni të lejoni persona të caktuar të afrohen me ju, mos kërkoni prej tyre favore që nuk mund t'jua plotësojnë.

DEMI Ka qenë një periudhë jo mjaft e mirë nga ana sentimentale dhe duhet të filloni të rivlerësoni persona të caktuar. Dikush ju ka lënduar pa të drejtë.

BINJAKËT Edhe pse kërkoni ndryshime në jetën tuaj, përsëri keni drojë ta merrni hapin e parë dhe ta hidhni pas krahëve situatën aktuale.

GAFORRJA Kaloni pengesat e vogla që keni me njerëzit pranë jush sepse sot më shumë se kurrë ju duhet bashkëpunim. Nëse veproni drejt do të merrni përfitime.

LUANI Këtë periudhë jeni të përqendruar në mbarëvajtjen e çështjeve tuaja profesionale dhe nuk doni të dëgjoni asgjë tjetër.

VIRGJËRESHA Keni zgjedhur të bëni shumë gjëra njëkohësisht sot, por nuk do të thotë që duhet t`i përfundoni të gjitha njëherësh.

PESHORJA Edhe pse keni bërë kompromise në të shkuarën, në situatën aktuale nuk ju pëlqen aspak të bëni kompromis me dikë.

AKREPI Vërtet nuk do të ndihmoni personalisht një mikun tuaj, por do ta gjeni mënyrën që persona të tjerë të merren me çështjen e tij të ndërlikuar.

SHIGJETARI Dikush pret që ta përfshini në një çështje të caktuar, por ju nuk jeni shumë të bindur në aftësitë e tij. Do të bëni çmos të mos i bini në sy.

BRICJAPI Duhet të krijoni një jetë tuajën personale që s'ka lidhje me punën apo studimin. Jo çdo gjë është e kufizuar vetëm në çështje financiare apo studimore.

UJORI Mos u mundoni të merrni hak për padrejtësitë që ju kanë bërë në të shkuarën. Do të ishte thjesht një humbje kohe për ju dhe për personat që ju duan.

PESHQIT Me kalimin e kohës edhe energjitë tuaja kanë rënë. Nuk do të jeni në gjendje të ndiqni më të njëjtat ritme si më parë projekte të caktuara.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	OLYMPIAKOS - LAMIA	1-1,3+	WILLEM II - AZ ALKMAAR	2	VALENCIA - BETIS	1

Zhdrella: E mposhtim Prishtinën

Mentor Zhdrella nuk e konsideron skuadrën e Llapit jashtë garës për titull. Ai ka paralajmëruar fitore të shtunën ndaj Prishtinës në "Zahir Pajzaiti". "Tash janë disa derbi radhazi në mes të skuadrave kryesuese dhe secila mund të dalë e mposhtur, prandaj Llapi është në këtë garë dhe do ta japim maksimumin që në fund ta arrijmë objektivin e klubit", ka thënë Mentor Zhdrella

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 SHKURT - Skuadra e Llapit vazhdon të pozicionohet në vendin e tretë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll por, pas humbjes në fundjavë në derbi ndaj Feronikelit, është shtatë pikë larg vendit të parë dhe pesë pikë larg vendit të dytë. Kjo nuk e shqetëson shumë mesfushorin Mentor Zhdrella, i cili paralajmëron se skuadra nga Podujeva është në garë për titull dhe se diferenca me skuadrat e para do të ngushtohet shumë shpejt. "Tash janë disa derbi radhazi në mes të skuadrave kryesuese dhe secila mund të dalë e mposhtur, prandaj Llapi është në këtë garë dhe do ta japim maksimumin që në fund ta arrijmë objektivin e klubit", ka thënë Zhdrella të mërkurën për "Epokën e re".

Skuadra e Llapit ndeshjen e radhës e zhvillon më 2 mars ndaj Prishtinës në stadiumin "Zahir Pajziti". Ish-lojtari që bëri historinë në futbollin e Kosovës duke u shpallur për disa vjet më i miri ka thënë se Prishtina është një kundërshtare e fortë, por pikët mbesin në Podujevë. "Do të jetë ndeshje interesante dhe një derbi i fortë, pasi synimet e të dy klubeve janë të njëjta. Pavarësisht prej formës që ka Prishtina, mund të them se gjithmonë është një skuadër e rrezikshme, prandaj ne duhet të kemi kujdes dhe mos të lejojmë gabime. Pres angazhim maksimal dhe fitore që na mban në garë për titull", ka shtuar Zhdrella.

Skuadra e Llapit aktualisht pozicionohet në vendin e tretë në renditjen tabelore me 38 pikë, ku nga 19 ndeshje të zhvilluara ka arritur 12 fitore, dy barazime dhe pesë humbje. Ndërsa nga gara e Kupës është eliminuar dhe titulli mbetet objektivi i vetëm i këtij klubi në këtë edicion garash.

Rrethi paraeliminator i Ligës së Kampionëve në 'Fadil Vokrri' dhe 'Adem Jashari'

PRISHTINË, 27 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës ka marrë një lajm të mirë nga UEFA. Në fakt, organi qeverisës i futbollit evropian ka vendosur t'ia besojë FFK-së organizimin e rrethit paraeliminator për Ligën e Kampionëve. Kjo do të jetë hera e parë që një ngjarje e tillë do të organizohet në Kosovë. FFK-ja kishte aplikuar me kohë për marrjen e organizimit të ndeshjeve të rrethit paraeliminator dhe në saje të partneritet shumë të mirë ndërmjet dy institucioneve, por edhe organizimit shumë të mirë që FFK-ja ka bërë në ndeshjet e Kombëtares në Ligën e Kombeve, të mërkurën ka ardhur lajmi pozitiv nga selia e UEFA-s.

Stadiumi "Fadil Vokrri" në Prishtinë, por edhe ai "Adem Jashari" në Mitrovicë, do të jenë arena ku klubi ynë kampion do të mund t'i mirëpresë skuadrat kampione nga San Marino, Andorra dhe Gjibraltari. "Kërkesa për organizimin e këtij rrethi nga FFK-ja është bërë me qëllim që t'i lehtësohet puna klubit tonë që do të na përfaqësojë në këtë garë: të ketë më pak shpenzime; ta ketë mundësinë për ta shijuar përparësinë e terrenit vendës dhe ta gëzojë përkrahjen e madhe të tifozëve në një garë kaq të rëndësishme, njëherësh si qëllim ka edhe faktin që klubi ynë të arrijë rezultate sa më të mira dhe në këtë mënyrë liga jonë të vlerësohet më lart dhe në të ardhmen të kemi më shumë ekipe pjesëmarrëse në garat evropiane", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Vitin e kaluar ky rreth paraeliminator u zhvillua në Gjibraltar, ku kampionia e Kosovës, Drita, arriti ta mbyllë me sukses, duke kaluar në rrethin e parë kualifikues, ku më pas u eliminua nga skuadra e njohur suedeze Malmo. Ndeshjet e rrethit paraeliminator do të zhvillohen prej 20 deri më 27 qershor 2019.

Prishtina kualifikohet në finale të Kupës

RAHOVEC, 27 SHKURT - Klubi i Basketbollit Prishtina, në kategorinë e femrave, ka arritur të kualifikohet në finale të Kupës së Kosovës, pasi ka mposhtur KB Bashkimin me rezultat 76:69. Çereku i parë i ndeshjes përfundoi me rezultat 25:10 në të mirë të vashave të Prishtinës. Në çerekun e dytë vashat nga Bashkimi ishin më të mira dhe kështu arritën ta ngushtojnë epërsinë duke shënuar 22 pikë, ndërsa ato nga Prishtina arritën të shënonin 14 pikë. Në çerekun e tretë të ndeshjes, Prishtina u rikthye duke arritur ta mbajë epërsinë e krijuar në pjesën e parë. Prishtina në këtë çerek u tregua më e mirë duke shënuar 22 pikë, ndërsa Bashkimi arriti të shënojë vetëm 17 pikë. Rezultati pas përfundimit të këtij çereku ishte 49 me 61 në të mirë të vajzave nga kryeqyteti. Ndërsa në çerekun e fundit, Prishtina vazhdoi me lojë të mirë, duke ruajtur epërsinë deri në fund të ndeshjes. Te skuadra e Prishtinës më e dalluara ishte basketbollistja Williams me 22 pikë të shënuara, pasuar nga Irma Konjusha me 21. Ndërsa te Bashkimi më e mira ishte amerikania Shaw, e cila u përjashtua në çerekun e tretë pas pesë gabimesh të shkaktuara.

Mourinho: 18 muaj pa trofe, dua një klub si Interi i tripletës

LONDËR, 27 SHKURT - Trajneri Jose Mourinho ka dhënë një intervistë për "Daily Telegraph", ku ka zbuluar edhe planet e ambiciet e tij për të ardhmen. Portugezi tregoi se kishte refuzuar një ofertë shumë të majme ekonomikisht këto kohë, pasi pretendonte, për faktin e thjeshtë, se klubi nuk kishte një projekt ambicioz për të fituar. "Këto kohë kam pasur një ofertë shumë mirë, që shumë do të thoshin se duhet të kem turp që e refuzova. Bëhej fjalë për shumë para, por ishte një skuadër që nuk luan në liga të mëdha dhe për objektiva të rëndësishme", ka thënë Mourinho. "U bënë 18 muaj që nuk fitoj trofe dhe kjo është diçka që nuk më kishte ndodhur ndonjëherë. Po përgatitem të rikthehem menjëherë këtë verë, ndonëse po shqyrtoj me shumë kujdes ofertat. Dua një klub ku të punoj me kënaqësi dhe ku e gjithë organika e skuadrës të jenë të gjithë në shërbim të së mirës së përbashkët. Tamam si kur isha tek Interi, ku bashkë me të gjithë drejtuesit mirëkuptoheshim dhe zgjidhnim më të mirën për të arritur te suksesi", ka deklaruar Mourinho.

Abrashi rrëfen makthin e dëmtimit dhe rikthimin

FREIBURG, 27 SHKURT - Pas fitores 5-1 kundër FC Augsburg dhe në prag të ndeshjes të shtunën ndaj Bayer Leverkusenit, ka folur mesfushori shqiptar Amir Abrashi. I rikthyer pas dëmtimit të gjatë, futbollisti i kombëtares kuqezi është rrëfyer për faqen zyrtare të klubit (scfreiburg.com).

Amir, si shpërblim për fitoren 5-1, stafi teknik ju la pushim dy ditë; përveç të dielës, edhe të hënën. Si e përdorët këtë kohë?
Abrashi: Ishte shumë mirë që pushuam këto dy ditë. Kjo nuk ndodh shpesh. Unë u ktheva në shtëpi, vizitova prindërit në Zvicër.

A u kthyet në situatë normale?
Abrashi: Sigurisht, tani jam plotësisht i qetë. Megjithatë, nuk do të zgjasë shumë. Të shtunën është ndeshja tjetër dhe natyrisht që duhet t'i rris ngarkesat përsëri.

Kundër Augsburgut e gjithë skuadra dukej përkohësisht në një gjatësi vale. Pse ndodhi kjo?
Abrashi: Ajo që kam vënë re, që para ndeshjes, ishte qetësia e të gjithë lojtarëve. Gjithkush në fushë u fokusua dhe bëri punën e vet. Prandaj, shkuam me fitoren 3-0 në pushimin mes dy pjesëve të lojës, çka ishte patjetër një avantazh i konsiderueshëm. Dhe shënuam akoma. Megjithatë, duhet të themi sinqerisht se fillimi ynë në pjesën e dytë nuk ishte aq i mirë. Nëse rezultati do të shkonte 2-3, gjithçka do të hapej përsëri.

Trajneri Christian Streich ju ka lavdëruar individualisht, pas asaj që bëtë të shtunën. Cili është përjetimi juaj, sidomos pas 11 muajve dëmtim dhe larg fushave?
Abrashi: Natyrisht, është mirë të dëgjosh vlerësime për atë që bën. Fatmirësisht, isha në gjendje të bëja ato që trajneri donte dhe më kërkoi. Jam shumë i lumtur që munda ta ndihmoj ekipin. Kjo ishte gjëja më e rëndësishme. Ne të gjithë duhet të qëndrojmë të përqendruar, sepse mund të bëjmë ende më mirë.

Keni vuajtur shumë, pothuajse një vit, për shkak të dëmtimit të rëndë të "ligamentit cruciat". Si i keni mbijetuar kësaj faze?
Abrashi: Kjo ishte një periudhë e vështirë për mua, një ndjenjë e çuditshme. Në fillim isha disi i qetë, por pas nëntë apo dhjetë muajsh u bëra gjithnjë e më i paduruar. Çdo fundjavë ishte e njëjtë, gjithmonë isha vetëm spektator.

Derisa në kampin e trajnimit në Sotogrande, kundër Mainzit, dhe në testet e U-23 kundër FC Basel II dhe FC Saarbrücken nisët të luanit disa minuta…
Abrashi: Ishte kënaqësi e madhe vetëm që isha në gjendje ta godisja topin përsëri. Këto ndeshje testuese ishin shumë të vlefshme për mua, sepse pas tyre luajta kundër Schalkes dhe Augsburgut.

Ju nuk keni pasur vështirësi kaq të mëdha, si në këtë dëmtim të gjatë?
Abrashi: Mendërisht, isha gati prej një kohe të gjatë. Kjo është arsyeja pse ishte e qartë për mua. Sa më shpejt që trajneri të më aktivizonte, do të jepja deri në 100 për qind të mundësive të mia. Fjala "familjarizim" nuk ekziston tek unë. Ne luajmë në Bundesliga, kemi nevojë për pikë. Kjo gjë më ka kaluar në kokë të shtunën.

Përkundër rehabilitimit, ju ishit të pranishëm në ekip gjatë gjithë kohës. Sa ju ndihmoi kjo?
Abrashi: Kjo ishte një shtysë e madhe dhe, ndoshta, ndodh vetëm te Freiburgu. Unë kam bërë kaq shumë gjëra me djemtë, kam qenë në atmosferën e ndeshjeve edhe pa qenë në gjendje të luaj një rol në fushe. E çmendur, apo jo? Kjo është unike dhe ta bën më të lehtë ingranimin, pas dëmtimit.

Një nga lojërat e shumta që keni ndjekur si spektator ishte barazimi 0-0 në fazën e parë kundër Bayer Leverkusenit. Ky është kundërshtari juaj i radhës që po zhvillon një gjysmë të dytë kampionati vërtet të mirë (36 pikë, vendi i shtatë). Çfarë mund të arrini në këtë transfertë?
Abrashi: Një sfidë e fortë na pret. Leverkuseni ka shumë potencial dhe është jashtëzakonisht i shpejtë në dyluftimet një kundër një. Kjo transfertë nuk do të jetë e lehtë për ne. Do të duhet të përfitojmë nga kundërsulmi sepse Leverkuseni do të sulmojë me forca të shumta.

Cila është dëshira juaj personale për javët dhe muajt e ardhshëm?
Abrashi: Dua të gëzoj shëndet të plotë, ta përshpejtoj arritjen e formës maksimale sportive, të fitoj pikë dhe të kënaqem çdo ditë me djemtë në fushë.

SHKURT

Cardiffi nuk paguan paratë e Salas, nis "lufta" ligjore me Nantesin

Historia e Emiliano Salas vazhdon të jetë në kujtesë të të gjithëve. Sulmuesi nga Argjentina humbi jetën pas rrëzimit të avionit kur po udhëtonte nga Nantesi drejt Cardiffit, kjo e fundit do të ishte skuadra e tij e re. Megjithatë, avioni humbi nga radarët dhe ra në det, ku pas disa javësh kërkim, trupi i tij u arrit të gjendej. Tashmë ka filluar një "luftë" mes Nantesit dhe Cardiffit për sa iu përket parave të transferimit të tij. Cardiffi nuk ka paguar kështin e parë prej 6 milionë eurosh dhe nga Nantesi kanë bërë të ditur se i janë drejtuar FIFA-s për këtë. Shuma totale do të jetë 17 milionë euro, ndërkohë që Cardiffi ka bërë me dije se do t'i paguajë këto para, por ende nuk ka vepruar. Tashmë klubet janë në një luftë ligjore, edhe pse Sala nuk jeton më.

Napoli, ofertë të 'çmendur' për Icardin

Skuadra e Napolit ka bërë një ofertë për Mauro Icardin, i cili pritet të largohet nga Interi. Sipas "Tuttomercato", Napoli ia ka ofruar një kontratë mjaft tunduese Icardit, sipas së cilës, sulmuesi do t'i fitonte nëntë milionë euro me klubin e ri si dhe dy milionë euro të tjera mund t'i fitojë përmes bonuseve. Nëse Icardi e pranon këtë ofertë dhe i refuzon ofertat e klubeve të tjera të mëdha të interesuara për të, atëherë ai do të bëhej lojtari i dytë me pagën më të lartë në Serinë A, pas Cristiano Ronaldos.

Werneri, afër Bayernit

Bayern Munchen ka arritur marrëveshje me agjentin e Timo Wernerit për të nënshkruar me sulmuesin gjerman, raporton "Sport Bild". Ylli i RB Leipzig ka ngjallur interesimin e disa klubeve evropiane, por ai më parë ka pranuar që do ta konsideronte transferimin te "Allianz Arena". Werneri ka kontribuuar me 14 gola dhe dy asistime këtë stinor, në gjithsej 25 paraqitje në të gjitha garat këtë stinor.

Llorente dëshiron te pensionohet në Bilbao

Sulmuesi i Tottenham Hotspurit, Fernando Llorente, e ka pranuar se dëshiron të pensionohet në skuadrën e Athletic Bilbaos. Sulmuesi spanjoll me plot sukses ka luajtur për këtë klub 2005 deri në vitin 2013, duke regjistruar 262 paraqitje dhe ka shënuar 85 gola. "Është folur shumë për një rikthim timin për ta mbyllur karrierën tek Atletik Bilbao, por e dija se do të ishte e komplikuar, duke parë dhe dëmtimet e shumta që pësoi 'Spursi' gjatë janarit. Nuk i kam bërë asnjë kërkesë Tottenhemit, por do të ishte diçka shumë e bukur që të rikthehesha te Bilbao dhe ta mbyllja karrierën atje", ka thënë Llorente.

Federeri: Ky është momenti që ndryshoi karrierën time

Roger Federeri ndodhet aktualisht në Dubai, ku dhe po luan në turneun ATP 500 që zhvillohet aty. Tenisti zviceran ka thënë se ky turne është i rëndësishëm për të për një arsye të veçantë. "Në Dubai kam fituar për herë të parë në vitin 2003. Në finale munda Jiri Novakun. Këtu ishin të gjithë tenistët më të mirë në botë të asaj kohe dhe në fund arrita të triumfoj", ka thënë Federeri. "Gjatë atij turneu mendoja: Nëse fitoj këtu, atëherë mund të fitoj edhe në mjaft turne të tjerë. Edhe në eventet grand slam. Ia dola mbanë dhe kisha të drejtë", rrëfen Federeri, duke kujtuar emocionet e përjetuara 16 vjet më parë. Federeri është në kërkim të titullit numër 100 në karrierën e tij dhe shpreson që këtë gjë ta realizojë pikërisht në Dubai, ku dhe nisi kjo histori suksesi. "Ai triumf në Dubai 16 vjet më parë ndryshoi karrierën time, pasi isha më i fortë psikologjikisht. Të korr këtu suksesin e 100 të karrierës time do të ishte diçka fantastike", u shpreh Roger Federeri, që në turneun e Dubait ka triumfuar shtatë herë në karrierën e tij.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/ L -149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Departamenti Ligjor

Titulli i vendit të punës: **Zyrtar i lartë ligjor**
Koeficienti / 8
Nr. i Referencës: MTI/ 3
Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1
Vendi: Prishtinë **Data: 28.02.2019**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë;
- Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën specifike si dhe ndihmon stafin tjetër të institucionit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;
- Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Është përgjegjës për pajtueshmërisë e projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi të Republikën e Kosovës;
- Bën rishikimin ligjor dhe gjuhësor, siguron që përmbajtja ligjore dhe teknike të jetë e saktë dhe identike në të tri gjuhët zyrtare. Si dhe përcjellë dhe menaxhon procedurat e hartimit dhe dorëzimit të projektligjeve në Qeveri;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së

  përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e institucionit;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: Fakulteti Juridik;
- Minimum 3 vite përvojë punë profesionale;
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës , të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese. Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

14/03/ 2019

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën **www.mti-ks.org** dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më**: 14/03/2019.** Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakon Br. 03/L -149, Uredba Br. 02/2010 o Procedurama Regrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Trgovine i Industrije obavlja:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Pravni Departman

Naziv radnog mesta: **Viši pravni službenik**
Koeficijent / 8
Referentni br: MTI/ 3
Broj službenika koji će biti prihvaćeni: 1
Mesto: Priština **Datum: 28.02.2019**

Dužnosti i odgovornosti:

- Razvija planove rada u skladu sa pretpostavljenim za realizaciju zadataka utvrđenih u osnovnim ciljevima jedinice i daje preporuke koje se odnose na realizaciju ciljeva jedinice;
- Upravlja radnim grupama iz stručne specifične oblasti kada je to potrebno, i obavlja specifične zadatke za specifičnu oblast kao i pomaže drugo osoblje institucije u sprovođenju svojih dužnosti i odgovornosti;
- U saradnji sa nadzornikom analizira i ocenjuje sprovođenje ciljeva i plana rada jedinice, priprema izveštaje o napretku i preporučuje poboljšanja ako je to potrebno;
- Sastavlja normativna akta i drugih pravnih akata koji proizilaze iz delokruga institucije u skladu sa postupcima utvrđenim zakonom;
- Odgovoran je za usklađenost nacrta zakona i drugih podzakonskih akata sa Ustavom i važećim zakonodavstvom Republike Kosovo;
- Vrši pravnu i jezičku reviziju, obezbeđuje da, pravni i tehnički sadržaj bude tačan i istovetan na tri jezika. Nadgleda i upravlja procedure izrade i dostavljanje nacrta Vladi;
- Sprovodi istraživanja i analize u vezi zakona i propisa u okviru odgovornosti i daje preporuke, savete i uputstva menadžmentu institucije;
- Obavlja i druge poslove u skladu sa ciljem radnog mesta koje od vremena na vreme mogu se zahtevati od strane nadzornika.

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska Diploma: Pravni Fakultet;
- Najmanje 3 godina radnog iskustva u struci;
- Duboko i specijalizovano znanje u oblasti zakonodavstva i izradi pravnih akata;
- Poznavanje važećih zakona i propisa;
- Veštine u komuniciranju i planiranju rada i rukovođenju tima;
- Istraživačke, analitičke i procenjujuće veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Uslovi za učešće na regrutaciji:

Pravo apliciranja imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju visoku školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje obaveza.

Trajanje imenovanja:

Službenik karijere (stalni). Probni period dvanaest (12) meseci.

Datum zatvaranja konkursa:

14/03/2019

Podnošenje prijave

Obrazac za prijavu se može dobiti na recepciji MTI-a, ili preuzeti sa *veb* straniceMTI-a, gde je i objavljen konkurs, na adresi **www.mti-ks.org** i dostavlja se Diviziji za Ljudske Resurse svaki radni dan od 8:00 - 16:00 do**: 14/03/2019.** Za detaljnije informacije možete kontaktirati broj tel. 038-200 36-578.

"Civilna Služba Republike Kosovo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu."

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupljenost organi civilne službe javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Članu 11, stav 3 Zakona Br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo"

Zahtevi pristigli nakon određenog roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih prijava biće kontaktirani samo kandidati sa užeg spiska.

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË KIESA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
